



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN ***Fakulteti Ekonomik***

Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel. +383 (0) 280390112

Nga Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi, Dekan

Dt.18.03.2020

Të dashur studentë,

Fillimisht uroj shëndet të plotë për ju dhe familjet e juaja!

Të detyruar nga situata e krijuar me pandeminë e Covid 19, Univeristeti "Kadri Zeka", dhe në këtë kuadër Fakulteti Ekonomik, nga data 19.03.2020, do të filloj me mbajtjen e mësimin online, përmes platformës meet.google.com. Materialet mësimore sikur edhe detyrat apo angazhimet tjera që do t'i merrni nga profesorët dhe asistentet, do të mund t'i shkarkoni/dërgoni në platformën moodle.

Qasja në platformën meet.google.com është e thjeshtë. Ju do të merrni linkun nga profesori/asistenti i lëndës, përkatësisht nga përgjegjësi i grupit tuaj (çdo drejtim ka nga një përgjegjës në secilin vit përkatës). Nëse haset ndonjë problem në komunikim do të kontaktoni përgjegjësit e grupit tuaj e më pastaj mësimdhënësit e lëndës.

Ju duhet që të qaseni përmes emailit zyrtar @uni-gjilan.net. Hyni në SMU dhe gjeni email adresat e sakta, në të kundërtën kontaktoni zyrtarët e IT. Eventualisht nëse për arsye të ndryshme nuk keni email zyrtar, atëherë mund të kyçeni edhe me adresa private nga platforma google (gmail).

Nga ju kërkohet që të jeni edhe më përgjegjës dhe të rregullt në ndjekjen ligjëratave dhe ushtrimeve sepse do të punohet në rrethana jonormale. Rregullshmëria në ndjekjen e ligjëratave dhe ushtrimeve është e domosdoshme për sukses.

Profesorët, dhe në veçanti asistentët, do të jetë të në gjendje dhe të gatshëm që t'ju dalin në ndihmë për përvetësimin e materies edhe gjatë kohës jashtë orarit të rregullt, përmes konsultimeve të ndryshme ose eventualisht të organizmit të ushtrimeve/konsultime shtesë.

Unë kam takuar në mënyrë online gjithë stafin e fakultetit si dhe përfaqësuesit e studentëve dhe jam i inkurajuar nga gatishmëria e shprehur nga të dy grupet për të vazhduar dhe për të qenë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë në mënyrë që procesi të jetë sa më efikas dhe efektiv që të jetë e mundur.

Duke shpresuar se së shpejti do të kthehemi në normalitet dhe do të shihemi në ambientet e Universitetit, ju dëshiroj shëndet të plotë juve dhe familjeve të juaja.

Na priftë e mbara!

I juaji,

Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi
Dekan i Fakultetit Ekonomik